



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-118

Prishtinë, më 1 korrik 2013, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 1 KORRIK 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Fikrim Damka dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Ambasada Amerikane në Kosovë: Bajram Geci.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit se këtë mbledhje e ka thirrur me kërkesë të kryetarëve të grupeve parlamentare të koalicionit qeverisës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia pasi diskutoi lidhur me propozimin për mbajtjen e seancës plenare, me shumicë votash, dy (2) ishin kundër (nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”), vendosi si në vijim:

a) Vazhdimi i seancës plenare

Seanca plenare, e filluar më 27 qershor 2013, t’i vazhdojë punimet më 4 korrik 2013 në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Votimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,*
- 2. Votimi i raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2012,*
- 3. Votimi i propozimit të Grupit Parlamentar SLS dhe të Grupit Parlamentar ‘ZB’ për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.*

b) Seanca e rregullt plenare të mbahet më 4 korrik 2013, në orën 10:30, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë,
6. Rekomandimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për procedimin e Projektligjit për transplantimin e organeve.

Ndërkaq, nënkryetari i Kuvendit z. Sabri Hamiti, ritheksoi se mban të njëjtin qëndrim sikur në mbledhjen e Kryesisë, të mbajtur më 1 korrik 2013 në orën 11:00, lidhur me mosrespektimin e kushteve dhe të afateve procedurale për shqyrtimin e parë të projektligjeve për seancën plenare me 4 korrik 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 15:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale